



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.261/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Socialdemokratska Unija (SDU), me seli në Prizren, të paraqitur kundër Subjektit Politik, Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, për shkak të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore, për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë:01.02.2025, merr këtë,

#### V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Socialdemokratska Unija (SDU), me seli në Prizren, Anr.261/2025 e datës;30.01.2025.
- II. Subjektit Politik Subjektit Politik, Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 2.500,00 Euro (dymijë e pesëqind) Euro.
- III. Detyrohet Subjektit Politik, Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

#### A r s y e t i m

Me datë;30.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjektit Politik Socialdemokratska Unija (SDU), me të cilën pretendon se subjekti politik, Nova Demokratska Stranka (NDS), të cilën e përfaqëson Emilia Rexhepi, më datë 29.01.2025, kanë bërë shpërndarjen e ushqimit për kafshë, në kohë të fushatës duke ndikuar te votuesit me qëllim të blerjes së votave, ku shihen edhe persona nga kabineti i zv.kryeministres me llaptop duke potencuar se ky veprim është keqpërdorim i detyrës zyrtare dhe pozitës. Si dëshmi për pretendimet e tij, paraqitësi i ankesës, ka bashkangjitur fotografit e shpërndarjes së ndihmave, fotografi të stafit në teren të publikuar në linkun e Emilia Rexhepi ku e njëjta poston “ premtimi i dhënë blegtorëve tanë është

përbushur” po ashtu edhe në postimin e Almir Veliji është postuar “ premtimi i dhënë blegtorëve tanë është përbushur”! Restelica ! Emilija Rezepi 1 në rrjetin social facebook.

Më datë 30.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Nova Demokratska Stranka (NDS), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më 31.01.2025.

Në përgjigjen në ankesë theksojnë se i kundërshtojmë pretendimet e SDU-së si të pavërteta, tendencioze dhe të motivuara politikisht andaj shpërndarja e ushqimit për bagëti u krye në kuadër të një donacioni humanitar nga TIKA, që ka pasur karakter ekskluzivisht humanitar me qëllim të ndihmonte blegtorët e prekur nga kushtet e rënda të dimrit. Me tutje ne përgjigje ne ankesë theksojnë se donacion nuk ka qenë i lidhur me ndonjë parti politike dhe nuk ka pasur ndonjë ndikim në procesin zgjedhor, andaj Partia e Re Demokratike (SKD) nuk kishte asnjë rol në sigurimin e fondeve, zbatimin e donacionit apo shpërndarjen e tij dhe prezenca e zyrtarëve nga Zyra e Zëvendëskryeministrit sipas pretendimeve ne ankesë nuk qëndron pasi që ne njoftimet zyrtare nuk përmendet se NDS-ja e ka realizuar këtë donacion. Po ashtu ne përgjigje ne ankesë theksojnë se në njoftime thuhet qartë se ky është një projekt i TIKA-s, i cili si gjithmonë është realizuar në bashkëpunim me institucionet. Kjo është praktikë standarde e TIKA-s, e cila mund të konfirmohet edhe përmes projekteve të tjera të kësaj organizate, andaj NDS-ja nuk ka pasur asnjë rol financiar apo organizativ në këtë donacion dhe as nuk ka pasur ndonjë ndikim në listën e përfituesve të grantit. Të gjitha vendimet për dhurimin janë marrë ekskluzivisht nga TIKA bazuar në kërkesat e fermerëve dhe një vlerësim të situatës së tyre.

Andaj duke u bazuar ne faktet e paraqitura me lart kërkojmë nga PZAP-i, ankesën ta refuzoj si të pabazuar dhe të parandalojë manipulimin e mëtutjeshëm të fakteve që kërcënojnë punën e organizatave ndërkombëtare dhe mbështetjen për komunitetin lokal.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës vëren se ankesa është e bazuar.

Paneli, pas shikimit të provave materiale, ku vërehet se persona nga kabineti i zv.kryeministres kanë marrë pjesë në shpërndarjen e ndihmave qoftë edhe në mënyrë admisitrave si dhe fotografi të stafit në teren të publikuar në linkun e Emilia Rexhepi ku e njëjta poston “ premtimi i dhënë blegtorëve tanë është përbushur” po ashtu edhe në postimin e Almir Veliji është postuar “ premtimi i dhënë blegtorëve tanë është përbushur”! Restelica ! Emilija Rezepi 1 në rrjetin social facebook, paneli konsideron se shpërndarja e ndihmave përkatësisht pjesëmarrja në shpërndarjen e ndihmave gjatë fushatës zgjedhore është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1.6, e LZP-së, me të cilën përcaktohet: “*premtimi i ndonjë shpërblimi financiar me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve*” e që sipas Panelit është vet Emilia Rexhepi dhe Almmir Veliji në postimet e tyre konfirmojnë premtimin e dhënë e që sipas tyre realizohet në kohë fushate.

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, ankesën e parashtruar e konsideron të bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera të përgjigjes në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin të pabazuara, të pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore si në dispozitat e Ligjit për Zgjedhje, dhe si të tilla nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka Paneli, vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 pika l.6, nenit 118 paragraf 1 dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A.nr.261/2025, datë;01.02.2025

Kryesues i Panelit

Skender Çoçaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118, paragrafi 4 të LZP-së.